



Titulli i Projektit:

Mbrojtja me prita malore e Përroit të Lekbibajt (Mërturi)

Titulli i objektit

RAPORTI I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS PËR
MBROJTJEN ME PRITA MALORE TË PËRROIT
LEKBIBAJT (MËRTURIT)

Punoi: KLEVIS BREGU

CERTIFIKATA: NR.611

Permbajtja

Hyrje

1) Informacion per qellimin e VNMDhe metodika e zbatuar.

- a) *Pershkrimi i qellimit dhe objektivat e VNM*
- b) *Pershkrimi i permbledhur i kuadrit ligjore mjedisor edhe instutucional qe lidhen me projektin*
- c) *Pershkrim te metodikes te zbatuar per hartimin e raportit te thelluar te VNM –se*
 - *Referencat per hartimin e raportit te thelluar te VNM-se*
 - *Metodika e zbatuar dhe menyra e sigurimit te informacionit per hartimin e raportit te VNM-se.*

2) Pershkrimi i projektit.

- a) *Pershkrimi i qellimit te projektit*
- b) *Planimetria e pergjithshme vendosjes se projektit*
 - *Sistemimi me prita malore i Perroit te Lekbibajt(Mërturit)*
 - *Seksioni i Perroit te Lekbibajt (Mërturit) qe do t'i neshtrohet sistemimit*
 - *Numri dhe lartesia e pritave te propozuara dhe projektuar ne perroin e Lekbibajt (Mërturit)*
 - *Tipi i pritave te propozuara dhe projektuar ne perroin e Lekbibajt (Mërturit)*
 - *Paraqitja skematike e pritave ne perroin e Lekbibajt (Mërturit)*
- c) *Pozicioni Gjeografik i Perroit te Lekbibajt (Mërturit)*

3) Hidrologjia

- *Kushtet klimatike te perroit te Lekbibajt (Mërturit)*
- *Rrjedhja e ngurte e pellgut te Lekbibajt (Mërturit)*

4) Programi per ndertimin e pritave.

- *Kohezgjatja e ndertimit*

5) Cili eshte impakti ne mjedis gjate ndertimit te prita-ve.

6) Informacion per lejet dhe licensat e nevojshme per projektin e kerkuar, nga ligjislacionit ne fuqi si dhe institucionet ne fuqi si dhe instutucionet kompetente perlejimin, licensimin e projektit.

7) Nje pershkrim i analizes te zbatimit te projektit dhe elementeve te vecante te tij, si dhe arsye per alternativen e zgjedhur duke marre parasysh ndikimet ne mjedis te seciles alternative.

8) Nje pershkrim i gjendjes dhe i vlerave egzistuese te mjedisit qe mund te ndikohen nga zbatimi i projektit te propozuar.

- **Pershkrimi i karakteristikave fizike te zones se projektit.**
 - *Pershkrimi i faktoreve klimaterik*

- *Pershkrimi gjeomorfologjik dhe i sizmicitetit i zones*
 - *Pershkrimi gjeologjik dhe tokes ne vendin e zbatimit te projektit*
- 9) *Pershkrimi i biodiversitetit ne zonen ku zbatohet projekti.***
- *Pershkrimi i habitateve kryesore ne zonen e projektit dhe harta ilustruese*
 - *Pershkrimi i vegjitacionit ne secilin habitat dhe statusi i ruajtjes kombetare dhe nderkomtar i tyre*
 - *Pershkrimi i zones se mbrojtur prane vendit ku propozohet projekti.*
 - *Te dhenat per bimesine.*
- 10) *Pershkrimi i cilesise se mjedisit dhe ndikimet egzistuese.***
- *Cilesia e ujrave ne zonen e studjuar.*
 - *Cilesia e ajrit ne zonen e studjuar*
 - *Niveli i zhurmave ne zonen e studjuar*
 - *Administrimi i mbetjeve*
 - *Presjonet kryesore te mjedisit ne zonen e projektit , si ndotje te mjedisit, prerje pyjesh etj.*
- 11) *Pershkrimi i karakteristikave sociale te zones ku do te zhvillohet projekt.***
- *Njesia e qeverisjes vendore qe administrohen zonen ku zhvillohet aktiviteti*
 - *Popullsia dhe aktivitetet kryesore ekonomike te zones*
 - *Perdorimi i tokes ne zonen e projektit*
 - *Vlerat dhe objektet monumentale dhe arkeologjike ne afersi te zones se projektit*
- 12) *Pershkrimi i ndikimeve negative te rendesishme te projektit te projektuar mbi mjedisin***
- a) *Ndikimet negative ne mjedis.***
- *Ndikimet negative ne karakteristikat fizike te zones se projektit*
 - *Ndikimet negative ne habitate dhe biodiversitet te zones se projektit*
 - *Shkarkimet ne mjedis dhe prodhimi I mbetjeve*
 - *Ndikimet negative shtese (kumulative) ne cilesine e mjedisit ne zonen e projektit dhe burimet natyrore si mineralet, pyjet, burimet ujore.*
 - *Ndryshimet sociale te projektit, si ndryshimi I perdorimit te tokes dhe shqetesimet qe mund te lindin nga ndikimet ne mjedis te projektit si zhurmat, pluhri, perdorimi i burimeve natyrore etj.*
 - *Pershkrimi i pasojave te aksidenteve te mundeshem me pasoja ne mjedis.*
- b) *Karakteristikat e ndikimeve negative ne mjedis.***
- *Metodat e zbatuara per parashikimin e ndikimeve ne mjedis*
 - *Shtrirja fizike dhe kohezgjatja e ndikimeve te indentifikuara*
 - *Lloji i ndikimeve te indentifikuara (direkte dhe jo indirekte*
 - *Mundesia e zbutjes se ndikimeve dhe argumentimet perkatese nese per ndikime te caktuara nuk mund te merren masa zbutese.*
 - *Zonat e ndjeshme ndaj ndikimeve te projektit si: zona te mbrojtura, habitate, qendra te banuara, burime ujore, zona arkeologjike etj.*
- 13) *Ndikimet ne mjedisin nderkufitar te projektit.***

14) Ndikimet positive ne mjedisin e zones se projektit.

15) Masat e propozuara per tu mbrojtur nga cdo ndikim negative ne zbatimin e projektit.

16) Programi i monitorimit te ndikimeve ne mjedis gjate zbatimit te projektit.

17) Plani i manaxhimit dhe monitorimit te mjedisit.

- *Rolet dhe pergjegjesit per zbatimin e seciles mase te propozuar per mbrojtjen e mjedisit ne secilen faze te projektit.*
- *Kostoja perkatesete zbatimit te masave te propozuara per mbrojtjen e mjedisit*
- *Plani i komunikimit dhe informimit te publikut per ndikimet ne mjedis, masat e marra per mbrojtjen e mjedisit dhe monitorimin e ndikimeve ne mjedis gjate zbatimit te projektit.*

18) PLANI I REHABILITIMIT

19) KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

1) Informacion per qellimin e VNM dhe metodika e zbatuar.**a) Pershkrimi i qellimit dhe objektivat e VNM.**

Objektivat e VNM-se konsistojne ne analizimin e faktoreve lokale e negative mjedisore, ne dhenien e masave zbutese per reduktimin e ndikimeve negative, si dhe ne permiresimin e vlerave ekologjike e rikrijuese te territorit gjate ndertimit te pritave malore me gabione dhe fleksibel qe do te ndertohen pergjate perroit te Lekbibajt (Mërturit).

Qellimi i VNM eshte, qe nepermjet vleresimit cilesor e sasior paraprak te parametrave hidrologjike te treguesve gjeologo-inxhinierike, parametrave sizmo-tektonike, morfologjike e gjeomorfologjike te bazuara ne kritere e standarte shkencore nderkombetare, te tipizohen dhe te perzgjidhen nje sere parametrash dhe veçorish te sistemeve te siperpermendur natyrore, ne sherbim te infrastruktures mjedisore dhe asaj urbane.

Ky raport ka per qellim te sherbeje:

- Si instrument per mbrotjen e mjedisit;
- Ne fuqizimin e komunitetit per veprime ne mbrojtje te mjedisit;
- Ne kontrollin e perdorimit te qendrueshem te burimeve natyrore;
- Ne rritjen e mireqenies nga menaxhimi afatgjate i burimeve ujore;
- Ne mbrotje te pasojave financiare dhe social-ekonomike;
- Ne rritje te interesimit per bashkepunim dhe ne gjetjen e zgjidhjeve te reja, etj

b) Pershkrimi i permbledhur i kuadrit ligjore mjedisor edhe instutucional qe lidhen me projektin.

Persa i perket bazez ligjore, referuar Fletores Zyrtare te Republikes se Shqiperise e cila eshte botuar nga Qendra e Botimeve Zyrtare, per ligjin nr 111/2012 "Per menaxhimin e integruar te burimeve ujore" jane perpiluar 101 nene nga te cilat kemi shkeputur disa prej tyre te dhena me poshte. Aplikimet per VMM kane si detyrim paketen ligjore te meposhteme:

- Ligji Nr. 10431, dt 09.06.2011 "Per Mbrojtjen e Mjedisit",
- Ligji nr 10440, datë 07.07.2011 "për vlerësimin e ndikimit në mjedis"
- Ligji nr 10448, datë 17.07.2011 "për lejet e mjedisit"
- Ligji nr 9774, datë 12.07.2007 "për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis"
- Ligji 10463, datë 22.09.2011 "për menaxhimin e integruar të mbetjeve"

- Ligji nr 1189, datë 18.11.2009 "për rregullat dhe procedurat për hartimin e zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit"
- VKM nr 24, datë 22.01.2004 "për veprimtarinë e inspektoriatit të mjedisit"
- VKM nr 103, datë 31.03.2002 "për monitorimin e mjedisit në republikën e shqipërisë"
- Ligji nr 8906, datë 6.6.2002 "për zonat e mbrojtura"
- Ligji nr 8905, datë 6.6.2002 "për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi"
- Ligji nr 7875, datë 23.11.1994 "për mbrojtjen e faunës së egër dhe gjuetinë"
- Ligji nr 7623, datë 13.10.1992 "për pyjet dhe policinë e shërbimit pyjor"
- Ligji nr 8672, datë 26.10.2000 "Për ratifikimin e konventës së Aarhusit "për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t'ju drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit"
- VKM nr 16, datë 4.1.2012 "për të drejtën e publikut për të pasur informacion mjedisor"
- Ligji nr 9334, datë 16.12.2004 "për aderimin e republikës së shqipërisë në protokollin e Kiotos të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për ndryshimet Klimatike"
- VKM nr 1553, datë 26.11.2008 "krijimin e Autoritetit Kombëtar të përcaktuar të mekanizmit të zhvillimit të pastër, në kuadër të zbatimit të angazhimeve të Protokollit të Kiotos"
- Ligji nr 91/2013 "Për vlerësimin strategjik mjedisor"
- VKM nr 597, datë 01.07.2015 "Për përcaktimin e rregullave e të procedurave dhe kërkesave të hollësishme për lidhjen e marrëveshjeve vullnetare, ndërmjet organizatave dhe grupeve që përfaqësojnë interesa të caktuara, grupeve të operatorëve ose operatorëve individual me autoritetet përkatëse, për realizimin e një niveli më të lartë mbrojtjeje, sesa ai i përcaktuar në legjislacionin e posaçëm, për një përbërës mjedisor"
- VKM nr 219, datë 11.03.2015 "për përcaktimin e rregullave e të procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjuesën publike gjatë procesit të Vlerësimit strategjik Mjedisor"
- VKM nr 620, datë 07.07.2015 "për miratimin e rregullave, përgjegjësi dhe procedurave të detajuara për vlerësimin strategjik mjedisor në kontekstin ndërkufitar"
- VKM nr 507, datë 10.06.2015 "Për miratimin e listës së detajuar të planeve apo programeve me pasoja negative në mjedis, që do të nënshtrohen procesit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor"
- VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësi e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore"
- VKM nr 575 datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte"
- VKM nr 229, datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit"
- VKM nr 418, datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim"

- VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 "Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit.
- VKM-së nr. 435, datë 12.9.2002 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën
- Ligji Nr. 9537 date 18.05.2006 "per Administrimin e Mbetjeve te Rrezikshme (i permiresuar me Ligjin Nr. 9890 date 20.03. 2008)"
- Ligji Nr. 9010 dt. 13.03.2003 "per Administrimin Mjedisor te Mbetjeve te Ngurta"
- Ligji Nr. 9115 date 24.07.2003 "per Trajtimin Mjedisor te Ujrave te Ndotura
- Ligji Nr. 9385 date 04.05.2005 "per Pyjet dhe Sherbimin Pyjor
- Ligjin 9791 date 23.07.2007 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin e mesiperm "per Pyje dhe Sherbimin Pyjor"
- Ligji Nr. 8405 dt 19.09.1998 "per Urbanistiken"VKM Nr. 853 date 28.12.2005 per miratimin e listes se mbetjeve te rrezikshme, mbetjeve dhe mbeturinave te tjera qe ndalohen te importohen me qellime ruajtje, depozitimi dhe asgjesimi"
- Ligji Nr. 9774 date 12.07.2007 "per Vleresimin dhe Administrimin e Zhurmes ne Mjedis"
- Ligji Nr. 9072 date 22.05.2003 "per Sektorin e Energjise Elektrike se bashku me te gjitha (me ndryshimet dhe shtesat sipas Ligjit nr. 9512 date 10.04.2006 "Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr.9072 date 22.05.2003 "Per sektorin e energjise elektrike", Ligjit nr. 9226, date 16.10.2006 "Per disa shtesa ne ligjin nr.9072 date 22.05.2003 "Per sektorin e energjise elektrike", te ndryshuar, Ligjit nr. 9750 date 04.06.2007 "Per disa shtesa ne ligjin nr.9072 date 22.05.2003 "Per sektorin e energjise elektrike", te ndryshuar, Ligjit nr. 9776 date 12.07.2007 "Per disa shtesa ne ligjin nr.9072 date 22.05.2003 "Per sektorin e energjise elektrike", te ndryshuar; Ligjit Nr. 9913, datë 5.5.2008 „Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr.9072, date 22.5.2003 "Per sektorin e energjise elektrike" te ndryshuar, Ligjit nr.9997 date 22.09.2008 " Per disa ndryshime ne ligjin nr.9072, date 22.5.2003 "Per sektorin e energjise elektrike" te ndryshuar, dhe Ligjit nr.10196 date 10.12.2009 "per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.9072 date 22.05.2003 "per sektorin e energjise elektrike"
- Ligji Nr. 9244 date 17.06.2004 "per mbrojtjen e tokes bujqesore"
- Ligji Nr. 111, dt.2012 " Per menaxhimin e Integruar te Burimeve Ujore

- Ligji Nr. 111, "Për menaxhimin e Integruar të Burimeve ujore ka si qëllim: a) Mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit ujor, të ujërave sipërfaqësore, qofshin të përkohshme apo të përhershme, të ujërave të brendshme detare, të ujërave territoriale, zonave ekonomike ekskluzive, shelfit kontinental, të ujërave ndërkufitare, të ujërave nëntokësore, si dhe të statusit të tyre; b) sigurimin, ruajtjen, zhvillimin dhe shfrytëzimin sa më racional të burimeve ujore, të domosdoshme për jetën dhe për zhvillimin social e ekonomik të vendit; c) shpërndarjen e drejtë të burimeve ujore, sipas qëllimeve të përdorimit dhe drejtimin e administrimit e efektshëm të tyre; ç) mbrojtjen e burimeve ujore nga ndotja, shpërdorimi dhe harxhimi mbi nevojat faktike; d) përcaktimin e kuadrit institucional, në nivel kombëtar e vendor, për vënien në jetë të një politike kombëtare për administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore në të mirë të komunitetit dhe interesave socialë dhe ekonomikë të vendit.

Fusha e veprimit e këtij ligji janë:

a) ujërat brendshme detare, ujërat territoriale, vijën bregdetare, zonën ekonomike ekskluzive, shelfin kontinental, ujërat sipërfaqësore e nëntokësore, së bashku me shtresat ujëmbajtëse dhe reshjet atmosferike, ujërat ndërkufitare, burimet natyrore dhe ujërat e lagunave e zonat e mbrojtura;

b) ujërat kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale, me përjashtim të ujërave minerale dhe gjeotermale që janë të përshtatshme për nxjerrjen e lëndëve të para minerare ose shfrytëzimin e energjisë termike të akumuluar për qëllime të prodhimit të energjisë, të cilat rregullohen me ligj të veçantë.

Objekti i ligjit është

Dispozitat e këtij ligji kanë si objekt të përcaktojnë:

- a) sigurimin, mbrojtjen dhe shfrytëzimin racional të burimeve ujore;
- b) zbatimin e planeve konkrete për përmirësimin e burimeve ujore, mbrojtjen e ujërave sipërfaqësore, të përkohshme apo të përhershme, të ujërave të brendshme detare, zonës ekonomike ekskluzive, shelfit kontinental, të ujërave ndërkufitare, të ujërave nëntokësore dhe të statusit të tyre;
- c) promovimin e përdorimit të qëndrueshëm të ujit nëpërmjet mbrojtjes afatgjatë të burimeve ujore;
- ç) zbatimin e metodave dhe kushtet për menaxhimin e integruar, përdorimin racional të burimeve ujore e mbrojtjen e cilësisë ekologjike të tyre;

-
- d) krijimin e strukturave administrative për menaxhimin e burimeve ujore, si dhe ushtrimin e funksioneve të tyre;
- dh) marrjen e masave për zbutjen efektive të përmbytjeve dhe thatësirave;
- e) monitorimin e statusit të ujërave, përdorimin racional dhe pakësimin e ndotjes;
- ë) parandalimin e përkeqësimit të mëtejshëm, mbrojtjen dhe përmirësimin e gjendjes së brigjeve, të ekosistemeve tokësore dhe ligatinave që varen drejtpërdrejt nga ekosistemet ujore.

Persa i perket me siper ligji pershkruan qarte se cilat jane kushtet dhe normat qe duhen plotesuar gjate fazes se ndertimit dhe operimit te veprave hidroteknike , ku investitori eshte i vetedijshem per te mare masa per sigurimin,mbrojtjen dhe shfrytezimin racional te burimeve natyrore, perdorimin e qendrueshem te ujit nepermjet mbrojtjes afatgjate gjate gjithë periudhes se koncensionit, pakesimin e ndotjes dhe zbatimin e metodave per mbrojtjen e cilesise ekologjike te burimeve natyrore.

Legjislacioni kerkon gjithashtu qe treguesit urban duhet te shfrytezohen racionalisht ne perputhje me principe te bazuara.Ndergjegjesimi ne Shqiperi eshte i nje niveli te ulet, kjo si rrjedhoje e nje legjisiaciani mjedisor relativisht te ri qe eshte ne zhvillim dhe po plotesohet me tej sidomos me rregullore dhe standarte. Vendi yne ka adoptuar një ligj për të aprovuar amendimet e Konventës së Bazel-it për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të substancave të dëmshme në Tetor 2004 dhe një ligj mbi klasifikimin e mbetjeve në shkurt 2005.

Në Dhjetor 2004, Ministria e Mjedisit nxorri direktiva të përbashkëta me Ministrinë e Transportit mbi kontrollin dhe nivelet e lejuara të ndotësve nga automjetet. Gjithashtu Keshilli I Ministrave ka marre disa Vendime te rendesishme ne kete fushe si:

- VKM Nr. 103 datë 31.03.2002 mbi "Monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë".
- VKM Nr. 994 date 02.07.2008 "per terheqjen e mendimit te publikut ne vendim-marrje per mjedisin"
- Dokumenti i Strategjise Kombetare te Biodiversitetit dhe Plani Veprimit
 - *Metodika e zbatuar dhe menyra e sigurimit te informacionit per hartimin e raportit te VNM-se.*

Studimi vleresimit te ndikimit ne mjedis u orientua

- nga rendesia e ndertimit dhe shfrytezimit te pritave ne perroin e Lerinit me standartet bashkekohore,
- nga permbushja e kerkesave vendase dhe te huaja,
- nga vendi ku do te ndertohen, pasurite natyrore e humane te zones si dhe vlerave te

vecanta te tyre,

- ne idenitifikimin e ndikimeve negative dhe lokale,
- ne marrjen e masave zbutese, duke patur parasysh ruajtjen e interesave ekonomike te investimit,
- ne masat orientuese per nje zhvillim te qendrueshem etj.

Ne kete raport indentifikohen ndikimet lokale pozitive dhe negative ne mjediset humane, si dhe eshte mare parasysh vleresimi i rrezikut.

Reduktimi i ndikimeve negative, eshte nderthurur edhe me ndikime te rendesishme lokale dhe strukturore ne keto faza kyesore:

- Hartimi i objektivave orientuese te Raportit te VNM-se;
- Mbledhja e materialit baze eksistues dhe plotesimi i formularit perkates per kete raport (relacioni teknik, studimi gjeologo-inxhinierik, hidrologjik, etj), si dhe seleksionimit te tyre;
- Hartimi i VNM-se dhe dorezimi tek porositesi, si dhe ne subjektet vendimarese dhe kontrolluese te aspekteve mjedisore ne nivel lokal dhe qendror.

2) Pershkrimi i projektit.

a) Pershkrimi i qellimit te projektit

Projekti shtrihet zonen e rrjedhjes se perroit të Lekbibajt(Mërtirit).

Qellimi i projektit eshte:

"MBROJTJA ME PRITA MALORE TË PËRROIT LEKBIBAJT (MËRTURIT)"

- *Ndertimi i pritave malore te Perroit te Lekbibajt(Mërturit)*

Pellgu i përroit të Lekbibajt ka një sipërfaqe prej 146 km² dhe shtrihet në pjesën lindore të Alpeve të Shqipërisë. Pellgu ujëmbledhës kufizohet nga m. Kakisë në perëndim (2358.7 m) dhe m. Shtresës (2190,0 m), m. Boshit në veri (2414.5 m) dhe m. Hekurave (2559.5 m), në lindje m. Dhive (2334.0 m) dhe m. Makinës (1780.0 m), në jug kufizohet me Liqenin e Komanit. Përroi i Lekbibajt përpara ndërtimit të HEC të Komanit dhe mbushjes së liqenit shkarkonte në lumin Drin rreth kuotes 135 m mbi nivelin e detit. Tashmë ai shkarkon në liqenin e Komanit në kuotat respektive të derivueshme të tij sipas planit të shfrytëzimit, por që në pjesën më të madhe të kohës së shfrytëzimit të deritanishem ka qenë ndërmjet kuotave 172-174 m mbi nivelin e detit. Në raste të veçanta kuota e liqenit të Komanit ka zbritur deri rreth kuotës 159,65 (25 Janar 1986) apo mesatarja mujore e muajve të verës të viteve 1992-93, rreth kuotës 162. Qëndrat e banuara brenda pellgut ujëmbledhës të Lekbibajt janë fshatrat; Brisë, Salcë, Palç, Peraj, Gjonpepaj, Lekbibaj, Tetaj, Shëngjergj, Curraj i Poshtëm, Betoshë, Qerreç Mulaj, Curraj i Sipërm. Në rrjedhjen e sipërme nuk ka qendra të banuara. Pellgu ujëmbledhës nga pikëpamja administrative i përket Qarkut të Kukësit, Rrethit të Tropojës dhe Njësisë Administrative Lekbibaj.

Zona Gjeografike: Tropoja kufizohet në veri me Republikën e Kosovës dhe të Malit të Zi, në perëndim me Bashkinë Shkodër, në jug me bashkitë Vau i Dejës dhe Fushë-Arrëz dhe në jug-lindje me Bashkinë Has. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Bajram Currit.



Pozicioni i pellgut ujëmbledhës të Lekbibajt

Kordinatat sipas Gaus Kruger


| X | Y |
|--------------|--------------|
| 4402348.3967 | 4697405.8056 |
| 4417452.161 | 4697405.8056 |
| 4680909.466 | 4402348.3966 |
| 4417482.161 | 4680909.466 |

Kordinatat sipas projeksionit KRGJSH

| X | Y |
|-------------|--------------|
| 488679.4577 | 4587841.2168 |
| 500264.2033 | 4687841.2188 |
| 485679.4577 | 4580472.2033 |

500264.2033

4680472.0311



. Hidrografia e pellgut ujëmbledhës të Lekbibaj

Për të eliminuar fenomenet negative si dhe për të reduktuar transportin e prurjeve të ngurta në grykederdhje të perroit të Lekbibajt (Mertirit) dhe shmangien e hyrjes të këtij materiali, do të hartohen një projekt i detajuar por pa përjashtuar zgjerimin e tyre në funksion të plotësimit sa më të mirë të qëllimeve të mesipërme që do t'i japë zgjidhje përfundimtare mbrojtjes së perroit nga efekti i depozitimeve të prurjeve të ngurta.

Projekti për perroit të Lekbibajt do të krijojë kushte për stabilizimin e regjimit të prurjeve të ngurta në rrjedhjen e poshtme të tij duke krijuar një hapësirë depozituese të lirë por edhe në zvogelimin e konsiderueshëm të pjerresisë së shtratit në këto zone që do të ketë efekte stabilizimi kundrejt erozionit si rezultat të zvogelimit të shpejtësive të rrjedhjeve.

- *Seksioni perroit të Lekbibajt që do të nënshtrohet sistemimit*

Perroi i Lekbibajt do të sistemohet me prita malore deri në burimin e prurjeve të ngurta. Në zbatim të kësaj është investiguar i gjithë perroi i Lekbibajt për të gjykuar mbi përcaktimin e masave inxhinierike që mund të merren për zgjidhjen e problemit të prurjeve të ngurta të transportuara prej tij. Duke gjykuar mbi qëllimin e projektit aktual, shtrirjen e tij, rëndësinë dhe problemin që mund të zgjidhen brenda efektivitetit ekonomik të tyre propozojmë risistemimin e tij duke filluar nga pikëbashkimi i dy degeve kryesore.

Faktorët bazë që përcaktojnë karakteristikat hidrologjike të zonës së projektit janë klima, topografia dhe gjeomorfologjia e saj. Pellgu ujëmbledhës i Lekbibajt shtrihet në pjesën lindore të Alpeve të Shqipërisë dhe pozicionohet ndërmjet pellgjeve ujëmbledhës të lumit të Valbonës në veri dhe verilindje dhe Shalës në veri-përendim dhe perëndim.

Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës është rreth 146 km². Gjatësia ujërrjedhëse e pellgut është rreth 15.7 km dhe pjerrësia mesatare e shtratit të degës kryesore është rreth 10.2% e cila është më e theksuar në pjesët e larta të pellgut dhe më e bute në rrjedhjen e poshtme të pellgut. Perroi i Marashit (degë e lumit Curraj) fillon në kuotën rreth 2000.0m dhe përfundon në bashkimin e dy lumenjëve lumi Curraj dhe lumi i Kuqit në kuotën 440.0m, me disnivel 1560 m mbi nivelin e detit dhe distanca në plan ndërmjet këtyre dy pikave 10.3km.

Në pellgun ujëmbledhës të Lekbibajt shtrihen fshatrat: Peraj, Gjonpepaj, Lekbibaj, Tetaj, Shëngjergj, Curraj i Poshtëm, Betoshë, Qerreç Mulaj, Curraj i Sipërm. Përrenjtë e Nikaj-Mërtur dhe Curraj i Epërm bashkohen në Curraj rreth kuotës 200 m duke formuar perroit të Lekbibajt i cili i shkarkon prurjet e saj në liqenin e Komanit. Me poshtë pikës së bashkimit deri në derdhje ka

përqendrime në sasi të mëdha inertesh (prurje të ngurta). Përroi kalon në një zonë ku shtrati i tijë vjen duke u zgjeruar dhe prezenca e prurjeve të ngurta është e dukshme deri në derdhjen e tijë në liqenin e Komanit, gjerësia e shtratit në derdhje arrin deri në 142m, prurjet e ngurta kanë interseptuar në brendësi të rrjedhës së lumit Drin (Liqeni i Komanit) duke penguar rrjedhën në një ngushticë, e cila ka tendencë të ngushtohet edhe më tej për shkak të mbushjes me prurjet e ngurta të sjella nga përroi Lekbibajt.

Përroi Lekbibaj është formuar nga derdhja në të e dy përrenjëve kryesorë, i përroit të Vogël (Lekbibajt) dhe i përroit Currajt, përkatësisht për sejcilën degë të përrenjëve në tabelën e mëposh

| Përroi kryesor i shkarkimit të pellgut ujëmbledhës | Degë që shkarkojnë në përroin kryesor Lekbibajt | Nën-degë të përrenjëve (të ndarjes A) | Përroska (të ndarjes C) |
|--|---|---------------------------------------|-------------------------|
| A | B | C | D |
| Përroi Lekbibajt | Lugina Currajt | Përroi i Pajës | Përroi i Marashit |
| | | | Përroi i Zajkut |
| | | | Përroi i Bashit |
| | | | Përroi i Qukës |
| | | | Përroi i Gërbetit |
| | | | Përroi i Pusterit |
| | | Lugina Currajt | Përroi Mrrishaj |
| | | Lugina e Kuqit | Përroi i Grykës Hapt |
| | | | Përroi i Rodhës |
| | | | Përroi i Gaonit |
| | | | Përroi i Draçkës |
| | | | Përroi i Aishtës |
| | | | Përroi Orteku i Frisë |
| | | | Përroi i Selbicës |

| | | | |
|--|----------------|----------------------|-----------------|
| | | Përroi Mulaj | |
| | | Përroi i Shëngjegjit | |
| | | Përroi i Gurit | |
| | Përroi i Vogël | Përroi Stakajt | Përroi i Bardhë |
| | | Përroi i Bardhë | |
| | | Përroi i Kabatit | |
| | | Përroi i Serës | |
| | Përroi Vargul | | |
| Shënim. Mungojnë disa përranj të cilat nuk kanë emërtim | | | |

Rrjeti hidrografik i pellgut të Lekbibajt (Mërturit) karakterizohet nga degë me pjerrësi të mëdha kryesisht në pjesën e sipërme të tij, por edhe në anën e poshtme të pellgut. Megjithatë duhet theksuar se në rrjedhën e poshtme në derdhje në liqenin e Komanit pjerrësia e shtratit ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme si rezultat i grumbillimit të prurjeve të ngurta në deltën e shkarkimit në këtë liqen. Kuota e shkarkimit në liqenin e Komanit është ngritur deri rreth kuotës 175-176 m duke ndikuar edhe në zvogelimin e pjerrësisë natyrale të shtartit të përroit.

Pellgu përbëhet nga sipërfaqe të thepisura me lugina të thella dhe të ngushta me një hidrografi të karakterizuar nga rrjedha të vullshme dhe të shkurtra dhe si rezultat të shoqeruara me gërryerje për shkak të shpejtësive të mëdha. Plotat maksimale në pellgun e Lekbibajt krijohen në periudhën e vonë të vjeshtës dhe gjatë dimrit. Për qëllimin e projektit llogaritjet hidrologjike janë bërë vetëm për prurjet maksimale duke llogaritur plotat për zgjatje të ndryshme të shirave si dhe periudhë përsëritje të ndryshme. Për llogaritjet hidrologjike janë shfrytëzuar të dhënat e dy stacioneve të Fierzës dhe Lekbibajt.

Nga pikëpamja gjeologjike pellgu ujëmbledhës i Lekbibajt në pjesën e sipërme dominojnë formacionet gëlqerore dhe dolomite të tjera në rreth 70% të saj. Ndërsa pjesa e poshtme e pellgut është e formuar nga shkëmbinj karbonatik mergelo-silicor me carje që zënë rreth 30% të sipërfaqes ujëmbledhëse.

Tokat që shtrihen në pellgun ujëmbledhës janë të hijta-kafe malore. Pjesa perëndimore e perroit të Lekbibajt përbëhet nga toka livadhore të kafenjta magneziale të shtrira ndërmjet kuotave 400 m deri në 1850 m mbi nivelin e detit dhe të veshura me pyje ahu. Në një vlerësim të përafert pellgu i Lekbibajt është i veshur me bimesi në rreth 50% të sipërfaqes së tij (pyje ahu dhe livadhe) që shtrihen kryesisht në pjesën veri-lindore dhe perëndimore të tij. Kushtet klimatike të zonës favorizojnë rritjen e një larmie pemësh që përfshijnë: Lisin (Qarri, Bungi, Bungbuta, Sparthi), Ahun, Pishën dhe Bredhin si dhe drurët dekorativë: Mështekna, Plepi i Egër, Bushi, Shelgu, Bliri etj. Brezi i kullotave alpine përfshin zonën e sipërme të pellgut ujëmbledhës. Zona e sipërme (Alpet) përbëhen nga male të thepisura me potencial të konsiderueshëm turistik si pasojë e ndërveprimit të akullnajave dhe erozionit me kullota të pasura alpine, të cilat kanë krijuar liqene akullnajore dhe bjeshkët e Tropojës. Ato karakterizohen nga kontraste të theksuara të lartësive me qafa të kalueshme dhe lugina të thella që përshkohen nga lumenj të shkurtër e të rrëmbyeshëm, që banojnë deri në thellësitë e tyre. Lartësia e konsiderueshme nga niveli i detit dhe variacioni i lartësi të terrenit malor dhe të kullotave alpine e bëjnë një hapësirë territoriale të favorshme për rritjen e bimëve medicinale. Në këtë rreth gjenden lloje bimësh mjekësore, ku spikat Boronica (*Vaccinium myrtillus*). Bimë të tjera mjekësore janë: dëllinja e zezë, molla e egër, sherebela, lule bliri, trumza, çaji i malit, luleshtrydhet (dredhëzat dhe medrat), trëndafili i egër, agulicja, qingela, lule shtogu, salepi, senza, lule basani, rrënjët e hithrës, kokrrat e shtogut, rigoni, bar pezma njëmijë gjethëshe, lule kamomili, thundërmushka, kulumbria, mëllaga, zhumbicat, shpatorja, ushejza pa kërcell e shumë të tjera. Bima e boronicës rritet në kullota alpine rreth 1200 – 1800 m mbi nivelin e detit.

- *Numri dhe lartësia e pritave të propozuara dhe projektuar në perroit të Lekbibajt.*

Per përcaktimin e numrit dhe lartësisë së pritave që do të projektohen për tu ndërtuar për sistemimin e perroit të Lekbibajt kemi bazuar në:

- Pjerresinë e shtratit të perroit në zonën e caktuar për sistemim.
- Pjerresinë e pranuar që duhet të ketë shtrati i perroit në anën e sipërme të pritave pas mbushjeve me aluvione.
- Kapacitetin grumbullues të depozitimeve pas ndërtimit të pritave.

Bazuar në kriteret e mesiperme janë propozuar dhe projektuar pritave mbrojtëse me dimensionet dhe parametrat e duhur.

- *Tipi i Pritave të propozuara dhe projektuar në perroit të Lekbibajt*

Bazuar ne disa kriteret dhe konkluzione te arritura nga demtimi dhe shkaterrimi i pritave te meparshme te ndertuara ne kete perrua apo struktura te ngjashme ne perrenj analoge jane propozuar dhe projektuar dy tipe pritash.

Tipi i pare eshte ai klasik i pritave me gabione me rrjete teli te zinguar dhe tipi i dyte eshte prita fleksibel te perdorura me efektivitet ne Europe dhe ne Botë në 20 vitet e fundit.

Pritat me gabione

Pritat me gabione jane me klasiket per sistemimet e perrenjve te perdorura me efektivitet per nje kohe te gjate dhe qe vazhdojne te perdoren me sukses edhe ne ditet tona. Ne perroin e Lerinit jane propozuar ne akset e caktuara. Eshte synuar te mos projektojme prita te ketij tipi me lartesi mbi 5 m. Nga eksperiencia e jetegjatesise se pritave te ketij tipi rezulton qe pritat me lartesi mbi 5 m jo vetem qe perdoren rralle por edhe potencialisht jane me te ekpozuara kundrejt demtimit dhe shkaterrimit nga energjitë e kaperderdhjeve te prurjeve por sidomos prurjeve te ngurta me fraksione te trasha dhe popla.

Ne perroin e Lekbibajt pritat me gabione te projektuara si mbilartesim i pritave ekzistuese, nuk do t'u nenshtrohen veprimeve dinamike te prurjeve te ngurta te trasha, zajeve apo poplave pasi ato do te stopohen ne pritat fleksibel te mbilartesuara, te projektuara siper tyre per te cilat do te flitet ne detaje ne seksionet qe vijojne.

Megjithate pritat e propozuara dhe projektuar me gabione jane siguruar nga te gjitha veprimet e pritshme te rrymave te plotes per te evituar cdo rrezik potencial te demtimit te tyre gjate shfrytezimit.


Pritat me zgara metalike (fleksibel)

Sic e permendem me siper ky tip pritash eshte perdorur ne 15-20 vitet e fundit por qe mbeshtetet ne studime dhe modele te thelluara teorike dhe praktike. Nevoja e tyre lindi per te mbuluar difektet dhe mangesite e pritave me gabione apo tipeve te tjera te perdorura per kete qellim.


Qellimi kryesor i zgjedhjes se ketij tipi pritash ne projektin e sistemimit te perroit te Lekbibajt eshte:


- Te eliminojmë efektin shkatërrues të zajeve dhe gureve të mëdhenj në pritat me gabione
- Ndarjen e fraksioneve të prurjeve të ngurta duke stopuar dhe grumbulluar zajat dhe poplat në këto prita dhe lejuar vetëm fraksionet më të imta për tu depozituar në pritat me gabione
- Shmangjen e nevojës për t'u inkastruar në një thellesi të madhe për të shmangur ndërtimin e strukturave të mëdha të shuarjes së energjisë. Prurjet e ujit të perziera me zaje dhe popla me madhësi të madhe zoteron energji shkatërruese të mëdha.
- Gjerësia e vogël në akset e zgjedhura do të kërkonte lartësi të madhe të rrymës për kalim të plotës llogaritesë si dërrjedhim energjia s
- Përcaktimet me metër linear të rrjedhjes do të ishin të konsiderueshme për tu shuar në anën e poshtme. Përseri do të kërkonte struktura shuarese të energjisë të mëdha.
- Thjeshtësi për tu ndërtuar në terrene të tilla dhe në kushtet e vështira të hyrjes në zonë
- Sasi minimale për t'u transportuar në zonën e ndërtimit dhe mjete të lehta dhe të manovrueshme në zonë të ngushta.
- Mundësi për të punuar në çdo kohë në shtratit e perroit pa patur rrezik për përmbajtje të punimeve dhe manovrimet të shpejta në raste të plotave të menjehershme të perroit. Përmbajtjet eventuale nuk sjellin dëmtime të mëdha në punimet e kryera.

Në perroitin e Lekbibajt janë ndërhyrjet skematike që mendohen të bëhen si më poshtë:




Profili gjatësor I Prroi Curraj.







Profili gjatesor I Proji Merturit.




Aksi Prites "L1" ne Prroin e Merturit




Aksii Prites "L2" ne Prroin e Merturit.




Aksii Prites "L3" ne Prroin e Merturit.




Aksii Prites "L4" ne Prroin e Merturit.




Aksii Prites "C1" ne Prroin e Curraj.




Aksii Prites "C2" ne Prroi e Curraj.




Aksii Prites "C3" ne Prroi e Curraj.



Aksii Prites "L5" ne Prroin e Curraj



Aksii Prites "L6" ne Prroin e Curraj.



Në figurën e mëposhtme jepet profile gjatësor I proit Curraj dhe I Proit Mërturit si dhe seksionet terthore me nivelet e ujit në secilin aks të përzgjedhur pwr të ndwrtuar pritat

3) Hidrologjia

Faktorët baze që përcaktojnë karakteristikat hidrologjike të zonës së projektit janë klima, topografia dhe gjeomorfologjia e saj. Pellgu ujëmbledhës i Lekbibajt shtrihet në pjesën lindore të Alpeve të Shqipërisë dhe pozicionohet ndërmjet pellgjeve ujëmbledhës të lumit të Valbonës në veri dhe veri-lindje dhe Shalës në veri-përëndim dhe perëndim.

Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës është rreth 146 km². Gjatësia ujërrjedhëse e pellgut është rreth 15.7 km dhe pjerrësia mesatare e shtratit të degës kryesore është rreth 10.2% e cila është më e theksuar në pjesët e larta të pellgut dhe më e bute në rrjedhjen e poshtme të pellgut. Përroi i Marashit (degë e lumit Curraj) fillon në kuotën rreth 2000.0m dhe përfundon në bashkimin e dy lumenjëve lumi Curraj dhe lumi i Kuqit në kuotën 440.0m, me disnivel 1560 m mbi nivelin e detit dhe distanca në plan ndërmjet këtyre dy pikave 10.3km.

Në pellgun ujëmbledhës të Lekbibajt shtrihen fshatrat: Peraj, Gjonpepaj, Lekbibaj, Tetaj, Shëngjergj, Curraj i Poshtëm, Betoshë, Qerreç Mulaj, Curraj i Sipërm.

Përrenjtë e Nikaj-Mërtur dhe Curraj i Epërm bashkohen në Curraj rreth kuotës 200 m duke formuar përroin Lekbibaj i cili i shkarkon prurjet e saj në liqenin e Komanit. Me poshtë pikës së bashkimit deri në derdhje ka përqendrim në sasi të mëdha inertesh (prurje të ngurta). Përroi kalon në një zonë ku shtrati i tij vjen duke u zgjeruar dhe prezenca e prurjeve të ngurta është e dukshme deri në derdhjen e tij në liqenin e Komanit, gjerësia e shtratit në derdhje arrin deri në 142m, prurjet e ngurta kanë interseptuar në brendësi të rrjedhës së lumit Drin (Liqeni i Komanit) duke penguar rrjedhën në një ngushticë, e cila ka tendencë të ngushtohet edhe më tej për shkak të mbushjes me prurjet e ngurta të sjella nga përroi Lekbibajt.

Përroi Lekbibaj është formuar nga derdhja në të e dy përrenjëve kryesorë, i përroit të Vogël (Lekbibajt) dhe i përroit Currajt, përkatësisht për sejcilën degë të përrenjëve në tabelën e mëposhtme jepen edhe degët e tjera të përroskave që shkarkojnë ujin e pellgut ujëmbledhës.

Rrjeti hidrografik i pellgut të Lekbibajt (Mërturit) karakterizohet nga degë me pjerrësi të mëdha kryesisht në pjesën e sipërme të tij, por edhe në anën e poshtme të pellgut. Megjithatë duhet theksuar se në rrjedhjen e poshtme në derdhje në liqenin e Komanit pjerrësia e shtratit ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme si rezultat i grumbillimit të prurjeve të ngurta në deltën e shkarkimit në këtë liqen. Kuota e shkarkimit në liqenin e Komanit është ngritur deri rreth kuotës 175-176 m duke ndikuar edhe në zvogelimin e pjerrësisë natyrale të shtartit të përroit.

Pellgu përbëhet nga sipërfaqe të thepisura me lugina të thella dhe të ngushta me një hidrografi të karakterizuar nga rrjedha të vrullshme dhe të shkurtra dhe si rezultat të shoqëruara me gërryerje për shkak të shpejtësive të mëdha.

Plotat maksimale në pellgun e Lekbibajt krijohen në periudhën e vone të vjeshtës dhe gjatë dimrit.

Për qëllimin e projektit llogaritjet hidrologjike janë bërë vetëm për prurjet maksimale duke llogaritur plotat për zgjatje të ndryshme të shirave si dhe periudhë përsëritje të ndryshme. Për llogaritjet hidrologjike janë shfrytëzuar të dhënat e dy stacioneve të Fierzës dhe Lekbibajt.

Nga pikëpamja gjeologjike pellgu ujëmbledhës i Lekbibajt në pjesën e sipërme dominojnë formacionet gëlqerore dhe dolomite të tjera në rreth 70% të saj. Ndërsa pjesa e poshtme e pellgut është e formuar nga shkëmbinj karbonatik mergelo-silicor me carje që zënë rreth 30% të sipërfaqes ujëmbledhëse.

Tokat që shtrihen në pellgun ujëmbledhës janë të hijta-kafe malore. Pjesa perëndimore e perroit të Lekbibajt përbëhet nga toka livadhore të kafenjta magneziale të shtrira ndërmjet kuotave 400 m deri në 1850 m mbi nivelin e detit dhe të veshura me pyje ahu. Në një vlerësim të përafert pellgu i Lekbibajt është i veshur me bimesi në rreth 50% të sipërfaqes së tij (pyje ahu dhe livadhe) që shtrihen kryesisht në pjesën veri-lindore dhe perëndimore të tij. Kushtet klimatike të zonës favorizojnë rritjen e një larmie pemësh që përfshijnë: Lisin (Qarri, Bungi, Bungbuta, Sparthi), Ahun, Pishën dhe Bredhin si dhe drurët dekorativë: Mështekna, Plepi i Egër, Bushi, Shelgu, Bliri etj. Brezi i kullotave alpine përfshin zonën e sipërme të pellgut ujëmbledhës. Zona e sipërme (Alpet) përbëhen nga male të thepisura me potencial të konsiderueshëm turistik si pasojë e ndërveprimit të akullnajave dhe erozionit me kullota të pasura alpine, të cilat kanë krijuar liqene akullnajore dhe bjeshkët e Tropojës. Ato karakterizohen nga kontraste të theksuara të lartësive me qafa të kalueshme dhe lugina të thella që përshkohen nga lumenj të shkurtër e të rrëmbyeshëm, që banojnë deri në thellësitë e tyre. Lartësia e konsiderueshme nga niveli i detit dhe variacioni i lartësi të terrenit malor dhe të kullotave alpine e bëjnë një hapësirë territoriale të favorshme për rritjen e bimëve medicinale. Në këtë rreth gjenden lloje bimësh mjekësore, ku spikat Boronica (*Vaccinium myrtillus*). Bimë të tjera mjekësore janë: dëllinja e zezë, molla e egër, sherebela, lule bliri, trumza, çaji i malit, luleshtrydhet (dredhëzat dhe medrat), trëndafili i egër, aguliçja, qingela, lule shtogu, salepi, sanza, lule basani, rrënjët e hithrës, kokrrat e shtogut, rigoni, bar pezma njëmijë gjethëshe, lule kamomili, thundërmushka, kulumbria, mëllaga, zhumbicat, shpatorja, ushejza pa kërcell e shumë të tjera. Bima e boronicës rritet në kullota alpine rreth 1200 – 1800 m mbi nivelin e detit.

LLOGARITJET E PRURJEVE MAKSIMALE ME SIGURI TË NDRYSHME

Për këtë kemi shfrytëzuar të dhënat e reshjeve të matura të dy stacioneve të Fierzes dhe Lekbibajt. Si rezultat përdorimi i metodës tradicionale të quajtur "RACIONALE" do të jepte rezultate të kënaqshme. Ekuacioni i metodës racionale është:

$$Q = k \times F \times i \times C$$

Ku:

Q – prurja maksimale që kërkohet në (m³/sek)

k – koeficient njësimi (pa dimensione) = 0.2857

F – Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës të Lekbibajt në derdhje në liqenin e Komanit (km²)

i – Intensiteti i reshjeve në mm/ore për kohën e bashkardhjes së llogaritur dhe sigurinë e pranuar të reshjeve

C – koeficienti i rrjedhjes që përcaktohet bazuar në karakteristikat gjeologjike dhe parametrave të veshjes së sipërfaqes së pellgut. Bazuar ne karakteristikat e sipërfaqes së pellgut dhe gjeologjisë koeficientin C e marrim 0.72.

Për përcaktimin e kohës së bashkardhjes ekzistojnë disa formula empirike. Ne do të zgjedhim formulën Bransby – Ëilliams për këtë llogaritje.

1. Formula Bransby -Ëilliams

Ku:

tc – koha a bashkardhjes në orë ose minuta

L – gjatësia e ujërrjedhes nga fillimet e saj deri në aksin llogaritës në (km)

A – Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës në km²

S – pjerrësia mesatare e përroit.

21.3 – koeficient njësimi pa dimensione

Bazuar sa me siper do të kemi:

$$T_c = (21.3 \times 15.7) / (146 \times 0.1 \times 0.1020.2) = 321 \text{ minuta ose } 5.35 \text{ orë}$$

Bazuar ne kohën e bashkeardhjes të llogaritur si më sipër si dhe grafikun 2 më sipër përcaktojmë saishnë e reshjeve të barabarte me 145 mm ose 27.1 mm/ore.

Llogarisim prurjen maksimale ne derdhje te perroit te Lekbibajt:

$$Q = k \times F \times i \times C = 0.2857 \times 146 \times 26.7 \times 0.72 = 814 \text{ m}^3/\text{sek}$$

Për siguri të ndryshme prurjet maksimale jepen në tabelën e mëposhtme:

| | | | | | |
|---|-----|-----|-----|-----|-----|
| Siguria në % | 1 | 2 | 5 | 10 | 20 |
| Prurja maksimale ne m ³ /sek | 803 | 724 | 643 | 561 | 452 |

RRJEDHJA E NGURTË E PELLGUT TË LEKBIBAJT

Përcaktimi i saktë i rrjedhjes së ngurtë të pellgjeve ujëmbledhës kërkon të dhëna për prurjet e ngurta si dhe prurjet e ujit të pellgut përkatës. Këto të dhëna mungojnë për pellgun e Lekbibajt. Një gjë e tillë na detyron ti drejtohem metodave alternative të llogaritjeve që sidoqoftë duhet të merren me rezerva.

Ekzistojnë shumë metodat për vlerësimin e rrjedhjeve të ngurta që burojnë nga erozioni i sipërfaqes së pellgut ujëmbledhës. Erozioni i sipërfaqes së pellgut varet kryesisht nga lloji i bimësisë së sipërfaqes dhe densiteti i saj, gjeologjia dhe gjeomorfologjia e sipërfaqes si dhe pjerrësia e pellgut. Më poshtë po japim një tabelle që jep thellësinë e erodimit të sipërfaqes së pellgut ujëmbledhës sipas karakteristikave të sipërfaqes së tij.

Tipi i mbulesës së pellgut ujëmbledhës Erozioni mesatar i sipërfaqes se eroduar (mm/vit)

Sipërfaqe pyjore e dendur pjesërisht 1.0

Sipërfaqe me shkurre dhe kacuba 0.8

Sipërfaqe e dendur me shkurre 1.2

Sipërfaqe e c'veshur 7.0

Sipërfaqe e tokes së kultivuar bujqësore 2.

Shkalla e erozionit për sipërfaqen pyjore dhe shkurret varion nga 0.8 – 1.2 mm/vit. Një vlerë mesatare prej 1.0 mm mund të merret për të përfaqësuar sipërfaqen e kombinuar të pyllit dhe shkurreve.

Bazuar sa më sipër, sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës të Lekbibajt është ndarë në tre zona që përfaqësojnë tre vlera të ndryshme të erodimit.

Sipërfaqe pyjore dhe shkurre 65 % ose 94 900 m³/vit

Sipërfaqe e tokës së kultivuar bujqësore 4 % ose 11 680 m³/vit

Sipërfaqe e c'veshur (përfshirë zonat e përrenjve, rrëshqitjeve, etj.) 31% ose 316 820 m³/vit

Prurjet e ngurta totale që grumbullohen nga pellgu i Lekbibajt vlerësohen rreth 423 400 m³.

- *Kushtet klimatike te pellgut te perroit te Lekbibajt*

Zona ku shtrihet pellgu i Lekbibajt bazuar në ndarjen klimaterike të vendit tonë (figura nr. 2) i përket zonës klimatike mesdhetare veriore. Temperatura mesatare vjetore lëkundet nga rreth 12o C në Lekbibaj në 12.30 ne Fierzë. Ndërsa temperatura minimale të regjistruara në Lekbibaj arrijnë deri në rreth -21o C dhe -19.80 C në Fierzë. Periudha me temperatura negative në zonë zgjat deri 73 ditë në vit ndërsa me temperatura më të vogla se -5o C zgjat deri në 14 ditë në vit.

Temperaturat maksimale të regjistruara në Lekbibaj arrijnë deri në 39.5° C dhe në Fierzë 37.9° C. Nga pikëpamja e sasisë së reshjeve që bien në zonë futet në zonat me më shumë reshje në Shqipëri. Sasia mesatare e reshjeve që bien në zonë lëkunden në rreth 2190 mm ne Lekbibaj dhe 2280 mm në Fierzë.

Për natyrën e projektit në shqyrtim rëndësi kanë reshjet maksimale për zgjatje të ndryshme dhe intensiteti i tyre. Reshjet maksimale 24 në Lekbibaj janë rreth 199 mm dhe në Fierzë rreth 279 mm. Intensiteti maksimal i regjistruar për stacionin Lekbibaj ka qenë 49 mm për 10 minuta dhe në Fierzë 58 mm. Për një periudhe prej 2 orë 26 minuta në Fierzë është regjistruar një sasi reshjesh prej 103 mm.

Zona e projektit karakterizohet nga intensitete të larta dhe zgjatje të konsiderueshme të këtyre intensiteteve në kohë. P.sh. në Fierzë (21.11.1973) për një kohe prej 14.40 orë kanë rënë rreth 209 mm. Brenda periudhes së mësipërme jane regjistruar intensitete më të larta, për një orë është regjistrua sasia e reshjeve prej 56 mm dhe për një periudhe 4 oreshë eshte regjistruar një sasi prej 136 mm.

Reshjet më të mëdha vjetore të regjistruara në stacionin e Fierzës ka qenë në vitin 1970 me 3440 mm dhe në stacionin Lekbibaj në vitin 1979 me 2800 mm.


Për stacionin e Fierzës parametrat klimaterike janë përmbledhur në tabelën

| | |
|-----------------|---|
| EMËRTIMI | VL. E PARAMETRAVE NE ST. FIERZES |
|-----------------|---|

| | |
|---|-------------|
| TEMPERATURA MESATARE VJETORE | 12.3 |
| TEMPERATURA MESATARE ME E LARTE NE VERE | 22.3 |
| TEMPERATURA ME E LARTE ABSOLUTE | 39.2 |
| TEMPERATURA MESATARE ME E ULET NE DIMER | 2.1 |
| TEMPERATURA ME E ULET ABSOLUTE | -21.5 |
| RESHJET MESATARE VJETORE | 2140 |
| RESHJET ME TE MEDHA VJETORE | 3440 |
| RESHJET ME TE VOGLA VJETORE | 1180 |
| RESHJET ME TE MEDHAJA 24 ORESHE | 279 |
| AVULLIMI MESATAR (E.T.P) (EV) MM | (430) (440) |
| LAGESHTIA MESATARE RELATIVE E AJRIT | 72% |
| DREJTIMI MBIZOTERUES I AJRIT (E) | N (7.4%) |
| SHPEJTESIA MAKSIMALE E ERES | 25 M/S |
| PRESIONI BAZE I ERES | 42 KG/M2 |
| TRASHESIA MAKSIMALE E BORES | 75 CM |
| TEMPERATURA E NGRIRJES SE TOKES NE 5 CM | -18.00 C |
| INTENSITETI I LEKUNDJEVE SIZMIKE | 7 Balle |

Parametrat klimaterike per stacionin e Fierzes(burimi: Raporti hidrologjik i projektit te meparshem

Rajonizimi klimatik. Ndarja e territorit të një vendi në zona e nënzona e në njësi të tjera më të vogla me kushte klimatike pak a shumë të njëjta, duke u mbështetur në regjimin shumëvjeçar të elementeve meteorologjike që rrjedhitt nga një radhë faktorësh (pozita gjeografike, lartësia absolute, largësia nga deti etj.),



Megjithëse përpjekje për R. K. të Shqipërisë janë bërë edhe para Çlirimit, si rajonizim i parë mund të merret ai i Drejtorisë së Shërbimit Hidrometeorologjik të Institutit të Shkencave (1355). Në këtë R. K. të Shqipërisë territori ndahet në 3 zona me nga 3 nënzona: I. Mesdhetare atlantike (V, qendrore e J); II. Kalimtare (V, qendrore e J,); III. Mesdhetare kontinentale (V, qendrore e J). Bazohet në dukjen e masave ajrore detare ose kontinentale të ftohta a të ngrohta, që mbizotërojnë në periudha të ndryshme të vitit.

Grumbullimi i të dhënave të shumta meteorologjike bëri të mundur një R. K. të ri të vendit të bazuar në kritere më shkencore që u paraqit më 1972 në studimin «Klima e Shqipërisë (shih).

Sipas këtij R. K. territori i Shqipërisë ndahet në 4 zona klimatike me 13 nënzona: I. Zona mesdhetare fushore (shih) me nënzonat V, qendrore e J; II Zona mesdhetare kodrinore (shih) me nënzonat V, qendrore, JL e JP; III. Zona

mesdhetare paramalore (shih) me nënzonat V e J; IV. Zona mesdhetare malore (shih) me nënzonat V, L, JL e J.

Zonat dhe nën-zonat e klimës së Shqipërisë.


RESHJET MUJORE DHE VJETORE TE ZONES SE PROJEKTIT

Reshjet mesatare mujore per dy stacionet e marre ne konsiderate jepen ne tabelen no.2

| Vendmatja | MUAJT E VITIT | | | | | | | | | | | | MESATARE VJETORE (MM) |
|---------------|---------------|-----|-----|-----|-----|----|----|----|-----|-----|-----|-----|-----------------------|
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | |
| Fierze (mm) | 259 | 254 | 184 | 175 | 135 | 78 | 57 | 91 | 159 | 238 | 316 | 332 | 2280 |
| Lekbibaj (mm) | 226 | 207 | 176 | 170 | 148 | 82 | 27 | 96 | 114 | 323 | 299 | 322 | 2190 |

Reshjet mesatare mujore dhe vjetore per stacionet e Fierzës dhe Lekbibaj

Në formë grafike reshjet mesatare të dy stacionet jepet në grafiku



Reshjet mesatare dhe vjetore në dy stacionet e Fierzës dhe Lekbibaj

Vlerat e reshjeve 24 orëshe për dy stacionet jepen në tabelen

| Vendmatja | MUAJT E VITIT | | | | | | | | | | | | VLERAT MUJORE MAKSIMALE |
|---------------|---------------|-----|-----|-----|----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-------------------------|
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | |
| Fierze (mm) | 161 | 140 | 125 | 144 | 81 | 101 | 98 | 169 | 279 | 138 | 231 | 155 | 279 |
| Lekbibaj (mm) | 125 | 107 | 140 | 178 | 63 | 90 | 135 | 132 | 160 | 199 | 192 | 135 | 199 |


Reshjet maksimale 24 orëshe për stacionet e Fierzës dhe Lekbibaj

Ndërsa vlerat e intensiteteve të reshjeve me periudhë zgjatjeje nga 10 minuta në 24 ore për stacionin e Lekbibaj jepen në tabelën

| Periudhe e zgjatjes se reshjeve | Perseritje ne perqindje | | | | |
|---------------------------------|-------------------------|-----|-----|-----|-----|
| | 1 | 2 | 5 | 10 | 20 |
| 10 minuta | 49 | 44 | 39 | 34 | 29 |
| 20 minuta | 61 | 55 | 49 | 43 | 37 |
| 30 minuta | 69 | 62 | 55 | 48 | 41 |
| 1 ore | 86 | 77 | 68 | 60 | 52 |
| 2 ore | 106 | 95 | 85 | 74 | 64 |
| 3 ore | 120 | 108 | 96 | 84 | 72 |
| 6 ore | 149 | 134 | 119 | 104 | 89 |
| 12 ore | 184 | 165 | 147 | 129 | 110 |
| 24 ore | 229 | 206 | 183 | 160 | 137 |

Intensitetet e reshjeve maksimale me zgjatje nga 10minuta në 24 orë për stacionin e Lekbibaj

Bazuar në tabelën e mësipërme ndërtojmë kurbat e varësise së sasisë së reshjeve nga koha e zgjatjes së tyre në grafikun



Grafiket e varesise se sasise se reshjeve per zgjatje te kohes dhe siguri te ndryshme ne Lekbibaj

Vitet me reshje maksimale dhe minimale dhe raportet përkatëse për stacionet e Fierzës dhe Lekbibaj jepet në tabelën

| Vendmatja | Rreshjet maksimale | | Rreshjet minimale | | Raporti ne mes rreshjeve min dhe max |
|-----------|--------------------|------|-------------------|------|--------------------------------------|
| | Sasia (mm) | Viti | Sasia (mm) | Viti | |
| Fierze | 3440 | 1970 | 1180 | 1953 | 2.9 |
| Lekbibaj | 2800 | 1979 | 965 | 2000 | 2.9 |

Reshjet maksimale dhe minimale dhe raportet përkatëse për stacionet e Fierzës dhe Lekbibaj

RESHJET NË FORMË BORE NË ZONËN E PROJEKTIT

Bora është fenomen i zakonshëm në zonën e projektit por ajo nuk qëndron për një kohë të gjatë në pellgun ujëmbledhës për shkak të ndikimit të liqenit të Komanit. Megjithatë ajo mund të krijojë shtresë dhe të qëndrojë më gjatë në dimra të jashtëzakonshëm me temperatura negative. Të tillë në histori kanë qenë dimrat e viteve 1937, 1944-45, 1954-55, 1962-63 dhe viti 1985. Bora nuk qëndron gjatë në shpatet që zbresin në liqenin e Komanit dhe qëndrojnë më gjatë në shpatet me ekspozim të kundërt me të.

Numri mesatar i ditëve me borë në zonën e projektit jepet në tabelën

| Vendmatja | MUAJT E VITIT | | | | | | | | | | | | NUMRI I DITEVE ME BORE |
|---------------|---------------|-----|-----|-----|---|---|---|---|---|----|-----|-----|------------------------|
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | |
| Fierze (mm) | 4.4 | 3.1 | 2.1 | 0.1 | | | | | | | 1.1 | 3.9 | 14.7 |
| Lekbibaj (mm) | 2.2 | 1.7 | 0.8 | 0.2 | | | | | | | 1 | 3 | 12.9 |

Ditët me borë gjatë një viti për stacionet e Fierzës dhe Lekbibaj

4) Cili është impakti në mjedis gjatë ndërtimit të pritave

Perroi i Lekbibajt ndodhet në bregun e majtë të liqenit të Komanit dhe zbret nga lartësia e fshatit Curraj i Epërm dhe Peraj. Në drejtim të tipareve gjeomorfologjike, lugina ku rrjedh perroi i Lekbibajt, karakterizohet nga tipare të ashpra morfologjike ku shpatet ngrihen dhe zbërsin rreptshëm në luginë deri në derdhejen e perroit në liqenin e Komanit.

Përroi i Lekbibajt përfshin dy degë të cilat karakterizohen nga një morfologji pothuajse e njëjtë pasi ndërtimi gjeologjik i shpateve në këto dy rrjedha është i njëjtë. Megjithatë fenomeni i erozionit është më i theksuar në degën e perroit të Currajve dhe dega kryesore e përroit Lekbibaj që derdhet në liqenin e Komanit. Ndërsa dega perëndimore duket deri diku e stabilizuar në drejtim të erozionit.

Në zonat e rrjedhave të poshtme, ku shpatet ndërtohen nga depozitime flishore të paleogjenit dhe ato permiane, lugina pëson deformime të shumta dhe zgjerim të shpateve.

Në teresi shtrati i perroit here ngushtohet dhe here zgjerohet në varesi të formacioneve ku ai kalon. Ky shtrat është në teresi i mbuluar nga pruluvione të trasha deri popullore, trashësia e të cilave luhet nga (2-3) m deri në (30-40) m në rrjedhën e poshtme. Shpatet e luginës në teresi në pjesën e rrjedhës në derdhje janë të veshura me bimesë, në rrjedhën e sipërme ku ata ndërtohen nga gelqerore janë të çveshura.



. Bashkimi i dy përrenjëve që vijnë nga Curraj i Poshtëm dhe lugina e Currajve për të formuar përroit e Lekbibajt.



Proluvionet në pjesën e sipërme të përroit Lekbibajt.



Proluvionet në pjesën e poshtme të përroit Lekbibajt.

5) Informacion per lejet dhe licensat e nevojshme per projektin e kerkuar, nga ligjislacionit ne fuqi si dhe institucionet ne fuqi si dhe instutucionet kompetente perlejimin, licensimin e projektit.

Korniza kryesore e kuadrit ligjor per pergatijen e ketij Raporti te VNM-se:

Ligji 111/2012, date 15.11.2012 'Per menaxhimin e integruar te burimeve ujore"

Ligji 10448, date 14.07.2011 "Mbi lejet mjedisore"

Ligji Nr. 10431, dae 09.06.2011 "Per mbrojtjen e mjedisit"

Ligji 10440, date 7.7.2011 "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis"

Ligji 10463, date 7.7.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve"

Ligji 8906, date 06.06.2002 "Per zonat e mbrojtura" i ndryshuar

Ligji 10006, date 23.10.2008 "Per mbrojtjen e faunes se eger"

Ligji 9587, date 20.07.2006 "Per mbrojtjen e biodiversitetit"

Ligji 9385, date 04.05.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor" i ndryshuar.

Ligji: "Per token", Nr.7501 date 27.01.1995.

Ligjin Nr. 7973,dt,26.07.1995 "Per konçensionet dhe pjesmarrjen e sektorit privat ne sherbimet publike dhe infrastruktures" ndryshuar me ligjet **Nr. 8105,dt**

28.03.1996,Nr.8329,dt.16.04.1998 dhe dekretin **nr. 1628.dt.17.10.1996.**

VKM Nr 13, date 04.01.2013 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësi e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis"

Udhezimi Nr 3, date 02.12.2013 "Per dokumentacionin e lejeve mjedisor"

6) Nje perskrim i gjendjes dhe i vlerave ekzistuese te mjedisit qe mund te ndikohen nga zbatimi i projektit te propozuar.

Pershkrimi i karakteristikave fizike te zones se projektit

TE DHËNA MBI NDERTIMIN GJEOLOGJIK TE PELLGUT TE LEKBIBAJT

Zona e lugines se perroit te Lekbibajt karakterizohet nga prania e depozitimeve te zones tektonike te "Alpeve", ku veçohen formacionet shkembore nga permi deri ne kuaternar. Ne keto depozitime me perhapje me te madhe jane ato te Krete-Paleogenit (Cr2m-Pg2), ndersa perhapje me te kufizuar kane ato te Kretakut te Siperim (Cr2) dhe te triasikut te Siperim (T3). Pergjate ketyre depozitimeve eshte zhvilluar lugina e perroit të Lekbibajt, e cila në rrjedhën e sipërme ecën në depozitimet rreshporo-gëlqerore të perimit dhe ato flishoidale të Krete-Paleogenit (Cr2m-Pg2), kurse në rrjedhën e poshteme ajo përshkon depozitimet e Kretës së Sipërme (Cr2) dhe të triasit të Sipërme (T3).

Ne funksion të përbërjes së tyre litologjike ato veçohen në formacione mbulesore dhe rrënjësore.

Keto formacione jane te natyres si eluviale, deluvione dhe proluvione. Depozitimet eluvialo - deluviale perfaqesohen nga suargjila deluviale te perziera me material çakellor, te cilat gjejne zhvillim ne shpatet qe ndertohen nga formacionet flishore, kurse proluvionet zene shtratin e perroit te Lekbibajt.

Ato perfaqesohen nga depozitime zhavorore te perberjes ranoro-gelqerore, kryesisht te trashe deri ne poplor. Mjaft te dallueshme keto depozitime jane ne shtratin e perroit te Lekbibajt pergjate gjithë rrjedhes deri ne grykederdhejn e tij ne liqenin e Komanit.

Karakteristike dalluese e ketyre depozitimeve eshte se ata kane trashesi nga (2-3) m ne rrjedhen e sipërme deri ne 10-15 m ne afersi te liqenit te Komanit arrijne deri ne 30 – 40 m. Zhavoret jane te perpunuar deri gjysem te perpunuar dhe te perzier me material çakellor, zhur dhe rere. Ne zonen e shtratit te perroit e cila mbulohet nga ujrat e liqenit te Komanit, keto depozitime krijojne deri shtresa ku dallohet fare qarte nje fare shtresezimi i tyre sipas trashesise, ku poplat e zajet zene pjesen fundore te shtratit ndersa materiali me i imet ze pjesen e sipërme te prerjes litologjike. Ne prerje mbizoteron materiali i trashe deri mesatar.

Poplat janë me të pakta por permasat e tyre shkojnë here-herë mbi (0.5÷1) m. Janë depozitime të rrjedhave të furishme të perroit në stinet me rreshje të shumta.

Perfaqësohet nga depozitime flishore të Krete-Paleogenit (Cr2m-Pg2) dhe ato karbonatike të Triasit e Kretes.

Depozitimet e Triasit të Siperme perfaqësohen nga gelqerore masive deri shtrese të trashë me ngjyrë gri të çelet. Përkohën nga një çarshmeri mjaft e zhvilluar, ku vërehen një numër sistemesh të cilat krijojnë në shpatet e luginës zona me dobësim dhe copetim të shkëmbit.

Depozitimet e Kretes vendosen në pjesën e sipërme të luginës. Janë gelqerore shtrese trashë deri në pllakore me ngjyrë të bardhë. Edhe këta janë në përgjithësi me shumë në çarje. Kanë rënie në lindje-verilindje me kënde (20⁰-25⁰).

Depozitimet e Krete – Paleogenit (Cr2m-Pg2) perfaqësohen nga depozitimet flishore argjiloro-panoro-alevrolitike të cilat kanë përhapje mjaft të gjera në zonë. Këto depozitime ndertojnë pjesët e sipërme të shpatëve të luginës. Në teresi janë të mbuluar nga mbulesa eluvialo-deluviale.

KUSHTET GJEOLIGO-INXHINERIKE TË ZONËS SË STRUKTURAVE TË MBROJTJES NGA PRURJET E NGURTA

Detyra specifike në studimin e kushteve gjeologjike të zonës së projektit ishte vlerësimi i parametrave kryesore të formacioneve shkëmbore dhe jo-shkëmbore i zonave ku do të ndërtohen strukturat mbrojtëse nga prurjet e ngurta të para-caktuara nga grupi i projektimit.

Siç u shpjegua më sipër, formacionet shkëmbore dhe joshkëmbore që ndertojnë bazamentin e luginës, në zonat e parashikuar për ndërtimin e strukturave mbrojtëse janë objekt i bashkëpunimit të pritave me to. Në këtë drejtim kërkohet njohje e vetive fiziko-mekanike të këtyre formacioneve dhe problematikës që ato mbartin lidhur me gjendjen dhe trashësinë e tyre.

Në këtë luginë në hapësirat e shtratit dhe nën të takohen dy lloj formacionesh. Formacioni zhavoror, ndërton shtratin e perroit të Lekbibajt nga derdhja në liqenin e Komanit e deri në rrjedhën e sipërme të tij.

Zhavoret janë në tërësi të trashë deri poplor, por ka zona sidomos në zonen e derdhjes së përroit në liqenin e Komanit, ku këto depozitime përbëhen nga zhavore të mesëm deri të imët, të cilat krijojnë edhe shtresëzime të veçanta. Shkaku i ndryshimit të granulometrise së depozitimeve kanë të bëjnë me natyrën e transportimit të tyre. Në rrjedhjen e sipërme pjerrësitë e përroit janë të mëdha, kështu edhe shpejtesitë, si rezultat i tyre është e mundur transportimi dhe rrokullisja e poplave të mëdha. Me zvogelimin e pjerresisë si rezultat i mbushjes graduale të përroit duke filluar nga grykederdhja në liqenin e Komanit dhe avancuar në drejtim të kundërt të rrjedhjes, zvogelohet shpejtesia dhe si rezultat mund të transportohen gjithnjë e më shumë depozitime të vogla deri të imëta. Por edhe litologjia e depozitimeve në grykederdhje ndryshon sipas fazave të mbushjeve të shtratit.

Këto depozitime janë produkt i prurjeve të përroit, i cili në periudhën e rreshjeve të rrembyeshme sjell shumë material të ngurtë dhe transporton në shtratin e tij zhavor, popla dhe gure të mëdhenj një pjesë e të cilave shkon deri në liqenin e Komanit. Trashësia e këtyre depozitimeve shkon nga (2-3) m, deri në (10-15)m dhe në afërsi të liqenit arrijnë deri në 30-40 m. Në përberjen granulometrike të tyre vërejtohen kryesisht zhavore të mesëm deri të trashë në masën (50-60)% dhe (10-15) % popla e zaje me diametër (30-50) cm e më shumë. Si rezultat i këtyre prurjeve është rritur ndjeshëm trashësia e zhavorëve duke arritur deri në nivelin e liqenit. Një dukuri që vërehet është se rrjedha e përroit ka mundur të gërryete dhe shpëllaje këto trashësi zhavorësh duke krijuar një shtrat që thellohet në këto depozitime dhe ndryshon rrjedhën herë pas here. Kushtet gjeologjiko-inxhinierike të akteve të paracaktuara për ndërtimin e strukturave mbrojtëse janë pothuaj të njëjta duke përjashtuar trashësinë e depozitimeve në shtratin e përroit e cila megjithatë nuk do të ndikojë në projektimin e strukturave duke marrë parasysh natyrën punuese të tyre. Në të gjitha akset e caktuara të strukturave dallojmë formacionet e mëposhtme me treguesit përkatës fiziko-mekanike

Depozitimet zhavorore të shtratit të përroit:

- **Treguesit e vetive fiziko – mekanike të zhavorëve janë :**

Pesha vëllimore ne gjendje natyrore $\Delta = 2.10 \text{ T/m}^3$
Moduli i deformacionit $E = (200-250) \text{ kg/cm}^2$
Kendi i ferkimit te brendeshem..... $\phi = 36^0$
Kohezioni..... $C = 0.0 \text{ kg/cm}^2$
Koefiçenti i ferkimit gur-gur..... $f = 0.5$
Ngarkesa e lejuar ne shtypje..... $\sigma = (2.5-3.0) \text{ kg/cm}^2$
Formacionet e shpateve:


Treguesit e vetive fiziko-mekanike te gelqeroreve jane:

Pesha vëllimore ne gjendje natyrore..... $\Delta = 2.65 \text{ T/m}^3$
Kendi i ferkimit te brendeshem..... $\phi = 33^0$
Kohezioni..... $C = 18 \text{ kg/cm}^2$
Moduli i elasticitetit..... $E = (200-250) \text{ kg/cm}^2$

• Vetite mekanike ne masiv sipas klasifikimit te Bienjavsikit :


Tipi i kalsifikimitII-III (masiv i mire deri mesatar)
Kendi i ferkimit te brendeshem..... $\phi=33^0$


Bazuar ne investigimet ne terren, hartave gjeologo-inxhinierike ekzistuese dhe matjeve jane perpiluar prerjet litologjike te seksioneve ku do te ndertohen pritat mbrojtese ne perroin e Lekbibajt.



Harta gjeologjike e Shqipërisë për zonën e projektit, sipas ASIG.

Më poshtë jepen prerjet gjeologjike tip në seksione të ndryshme





7) Pershkrimi i biodiversitetit ne zonen ku zbatohet projekti.

- Pershkrimi i habitateve kryesore ne zonen e projektit dhe harta ilustruese.

Flora dhe fauna:

Ekosistemet, habitatet dhe pejsazhet ekzistuese, statusi i mbrojtjes se tyre (i mbrojtur, vecanerisht i mbrojtur) dhe statusi i ruajtjes (i favorshem, i pafavorshem)

Flora.

Zona ku eshte parashikuar per te ndertuar objektin, ne afersi ka bimesi tip dushqesh, vende vende deri ne te drunjte.

I gjithë peisazhi fiton një pamje ku dominancën e zoterojnë dushqet. Dushqet mbizotërohen nga qarri (*Quercus cerris*) me shkurret e shkozës (*Carpinus* sp.), lajthisë (*Corillusavellana*), dëllinjës (*Juniperus* sp.) dhe shpesh bushit (*Buxus sempervirens*). Në drejtim të lindjes shkurret mesdhetare bëhen më të rralla, dhe llojet gjithnjë të blerta zëvendësohen nga llojet gjetherënëse. Më kryesorët e këtij brezi janë mareja (*Arbutus unedo*), shqopa (*Erica arborea*), driza (*Paliurus aculeatus*), dëllinja (*Juniperus* sp.) si dhe geshtenja, panja e malit, plepi kavak, plepi i zi etj. te dhena këto të mara nga Drejtoria Pyjore e Rrethit Tropoje.

FAUNA

- a. **Perberja në lloje ekzistuese dhe statusi i mbrojtjes së tyre (i mbrojtur, veçanërisht i mbrojtur, i rrallë, i kërcënuar, endemik) dhe statusi i ruajtjes (i favorshëm, i pafavorshëm).**

Fauna e Egër

Zona e liqenit të Komanit përbën një tërësi me mjaft rëndësi për faunën e egër duke përfshirë, insektet, peshqit, reptilët, shpendët dhe gjitarët. Deri tani janë raportuar rreth 27 taksone gjitarësh, 280 lloje insektesh, 10 amfibë, 17 reptilë, dhe disa lloje peshqish, dhe 167 lloje shpendësh.

Gjitarët

Zona në shqyrtim është vend jetese për mjaft gjitarë gjërësisht të kërcënuar në Evropë. Janë regjistruar rreth 27 lloje gjitarësh si të pranishëm në rajon edhe pse këtu mungojnë kërkimet përkatëse sistematike cilësore dhe sasiore. Në tërësinë e *mammalofaunës* takohen llojetë rëndësishëm si ariu, ujku dhe rrëqebulli (për zonën më gjërë). Në mes të 27 llojeve të gjitarëve 9 prej tyre janë lakuriq nate, 3 insektivorë, 7 rodentë, 5 karnivorë, 2 *artiodactyla* dhe 1 lloj lepur.

Shtatë prej 27 llojeve të gjitarëve trajtohen si globalisht të kërcënuar ose te rezikuar (*Rhinolophus ferrumequinum*, *R. blasii*, *R. hipposideros*, *Miniopterus schreibersi*, *Myotis capaccinii*, *M. myotis*, *Canis lupus*). Rëndësia e zonës përth, për 5 lloje të veçanta të gjitarëve

(Burimi Pyjet e Virgjer te Shqiperise, WB 1997).

| Zona pyjore | Ariu | Ujku | Rreqebulli | Dhie eger | e | Kaprolli |
|-------------|-----------------|-----------------|-----------------|-----------------|----|----------|
| | Nivel ne rritje | Nivel ne rritje | Nivel ne rritje | Nivel ne rritje | ne | e ulet |

Shpendët

Avifauna e ekosistemeve ujore e terestiale të zonës ofron një larmi biologjike të lartë me rreth 167 lloje shpendësh. Gjithashtu karabullaku i vogël (*Phalacrocorax pygmaeus*) shumëzohet dhe dimëron në rajonin e gjërë të marë në konsideratë.

Fauna akuatike

Studimet istiolgjike për ujrata e brendshme, (sidomos për lumenjtë) kanë qënë të pakta. Referenca për peshqit e liqenit te fierzes është e papërfillshme. Të dhënat e para jepen në publikimet e mëparshme të Cake et al, të cilat ndër të tjera marrin në shqyrtim edhe ndotjen e mjedisit.

Llojet e gjetura, u takojnë rendeve: *Anguilliformes*, *Cypriniformes*, *Mugiliformes* dhe *Clupeiformes*, ku familja *Cyprinidae* është dominuese me 12 lloje, ose rreth 70.58 % të llojeve të gjetura; grupet e tjera janë të përfaqësuara vetëm nga një ose dy lloje.

- a. Te drejtat per te perdorur perberesit e biodiversitetit duke perfshire dhe perdorimet tradicionale te popullatave lokale.

Mikroalgat

Mikroalagat janë një grup heterogjen arbitrar ku përfshihen të gjithë organizmat bimorë njëqelizorë ose kolonialë që popullojnë pjesën e ndriçueshme të mjediseve ujorë të kapur në fund mbi substrate të ndryshme (fitobentosi) ose duke qëndruar pezull në ujë (fitoplanktoni). Në këtë kategori ka shume grupe por më të rëndësishmet nga ana llojore dhe ekologjike janë diatometë (*Bacillariophyceae*), peridinetë (*Dinophyceae*), kokolitoforidet (*Chrysophyceae*), klorofitet (*Chlorophyceae*) dhe algat blu të gjelbërta (*Cyanophyceae*). Këto organizma janë prodhuesit parësorë dhe përbëjnë nivelin e parë ushqes në këto mjedise.

Keto habitate zhvillohen shumë në fundin e pranverës dhe gjatë verës, ndërsa në dimër arrihet minimumi i tyre. Llojet e gjetura u përkasin ujërave përgjithësisht të ndotura-*mezosaprobe*, me lëndë organike të lartë, oksigjenim mesatare, që karakterizohen për shumëllojshmëri të lartë të bimëve dhe kafshëve mikroskopike, dhe janë të përshtatshme për peshkim, sidomos ciprinide.

- *Pershkrimi i vegjitacionit ne secilin habitat dhe statusi i ruajtjes kombetare dhe nderkombetar i tyre*

Mjedisi Tokësor dhe Ligatinor

Karakteristika kryesore e zonës së marrë në shqyrtim është se në një territor shumë të vogël takohen lloje të ndryshme ekosistemesh duke përfshirë ato malore, lumore, të ujërave të ëmbëla (e rezervuarë), si dhe ekosisteme bujqësore ose agro ekosisteme. Zona në të dy anët e liqenit te Komanit tipizohet për nga larmia morfologjike si dhe procese aktive të depozitimit të sedimenteve dhe grumbullimit, një rrjet interesant hidrologjik dhe sedimente fine që transportohen në shtratin e gjërë.

Vegjetacioni tokësor në këtë zonë i përket kryesisht karakterit të Europës Qendrore Kontinentale, me prani të pak elementëve mesdhetarë. Formacionet bimore të tërësisë tokësore shprehin një larmi formash, duke u zhvilluar ne mjediset e ulta afër ujembledhesve

dhe Perrenjve ku sistemet e kulturave bujqësore dominojnë, në rajonet me lartësi të mesme e të madhe, e deri në zonat e kullotave alpine.

Në fushat e ulëta dhe kodrat, janë përshkruar një larmi formash barishtore si më poshte vijon: vegjetacioni i barishteve të këqija ndaj kulturave bujqësore, *vegjetacioni nitrofil*, dhe *vegjetacioni anash rrugor*, *vegjetacioni amofil*, i kullotave të ulta e kodrinave, vegjetacioni i livadheve mocalore, dhe vegjetacioni i sistemeve pyjore.

Duke u mbështetur në vëzhgimet e deritanishme, ekosistemet natyrore të kësaj zone përbëhen nga një tërësi nën habitatesh si ato të sistemeve të përhershme ujore, të kanaleve kullues e ujitës, ekosistemeve të rezervuareve, bankinave të sistemeve rrjedhëse ujore etj.

Bimët e rralla

Ekosistemet tokësore të zonës i përkasin nën ndarjes ballkanike të zonës së vegjetacionit Sub-Mesdhetar. Këtu mund të vecohen tre nënzona *fitoklimatike*, si më poshtë:

- zona e dushkut,
- zona e shkurreve
- zona e bimeve të uleta.

Masivet gëlqerorë malorë të majave të majeve përreth popullojë disa biotope të jashtëzakonshëm dhe me vlera për ruajtjen natyrore në nivel Evropian. Vrojtimit tregojnë se, këtu takohet një numër prej rreth 78 lloje të dendroflorës. Mund të presupozohet që këto lloje të takohen edhe në afërsi të rajonit në studim si një zgjatje e sistemit në drejtim të masiveve të kodrave përreth.

Brezi i zonës së dushkut nis nga lartësia 600 m deri në 1300 m. në pjesë të konsiderueshme e këtij brezi përdoret nga bujqësia. Pjesa e dendroflorës në këtë sistem dominohet nga llojet

e dushkut (*Quercetum*) me *Quercus petraea*, *Q. frainetto*, *Q. pubescens* ose *Q. cerris*. Drurët e dushkut me *Ostrya carpinifolia* dhe *Carpinus orientalis*, duke treguar një tendencë për përzjerje *Ostryo-Carpinion orientalis* në nivelet më të ulta të lartësive, që janë gjithashtu pjesë e kësaj zone.

Në vendet e thata dhe shkëmbore dominon *Quercus trojana* (*Quercetum trojanae*). Gjithashtu në mjedise të tilla të ngjashme shfaqet lloji drunor i venjës (*Juniperetum excelsae*). Duke u bazuar në faktin se sistemet drunore shpesh herë paraqiten të vecuara, si dushqet ashtu edhe venjat, në këto biotope hapësirat mbushen me barishte të tilla si *Stipa grasslands* (*Festucetalia*).

Në mënyrë rastësore në sipërfaqe të vogla janë instaluar nga ana e njeriut sisteme të pyjeve me pisha në brezin e dushkut, kryesisht afër qendrave të banuara.

Në pjesën e sipërme të brezit të dushkut takohen komunitete në larmi si *Festuco-Brometea*. Një përzjerje e elementeve Kontinentale dhe sub Mesdhetarë është tipike në rastet e kalimit nga format kontinentale *Festucetalia* dhe *submediteranea Brometalia*. Zonat e lagura të rajonit ose anët lumore janë të varfëra në veshje dushqesh. Në vende të tilla sistemet e kufizuara ligatinore rrethohen nga kullotat e tilla si tipi *Arrhenatheretum* ose nga sistemet fushore.

Duke u mbështetur në vërtetimet e ndryshme, besohet se 25 lloje bimësh të florës lokale i takojnë listës të florës së kërcënuar të Shqipërisë. Nëntë prej tyre janë në nivelin e kërcënimit lokal dhe dy lloje trajtohen si endemike.

Pershkrimi i zones se mbrojtur prane vendit ku propozohet projekti.

Kjo zonë (Zona ku do të ndërtohen pritat e reja dhe mbilartesimi i atyre ekzistuese), nuk gëzon statusin e ndonjë kategorie të mbrojtur (sipas IUCN-s kategorizim i adaptuar nga vendi ynë), si dhe në afërsi të saj nuk ka të tilla me status mbrojtjeje, megjithatë në kuader të rritjes se

siperfaqeve te konsideruara si zona te mbrojtura dhe qe jane ne liste per te marre statusin e vecante te mbrojtjes, ky aktivitet mund te integrohet me keto zona me se miri pa e prishur rendesine e tyre.

8) *Pershkrimi i cilesise se mjedisit dhe ndikimet egzistuese.*

- *Cilesia e ujrave ne zonen e studjuar.*

Rrjeti hidrografik i pellgut te Lekbibajt karakterizohet nga dege me pjerresi te medha, megjithese kjo pjerresi eshte zvogeluar si rezultat i ndertimit te pritave, kryesisht ne pjesen e siperme te tij por edhe ne anen e poshtme te pellgut.

Pellgu perbehet nga nga siperfaqe te thepisura me lugina te thella dhe te ngushta me nje hidrografi te karakterizuar nga rrjedha te vrullshme dhe te shkurtra dhe si rezultat te shoqeruara me gerryerje te konsiderueshme per shkak te shpejtesive te medha te gjeneruara. Persa i perket akuifereve ne kete rrjedhe ujore jane te tipit malor me klime te ashper gjate dimrit dhe te fresket gjate veres. Ne keto ujera verehen lemyshqet dhe algat lumore qe vishen ne faqen e gureve. Cilësia e ujërave të ujitjes është e e mirë dhe ato duhet të përdoren për ujitjen e bimëve që kultivohen në këto zona.

Nuk shkakton probleme të kripëzimit dhe toksicitet në bimët e ndjeshme, por mund të shkaktojë probleme të lehta të infiltrimit në tokë, duke ulur shpejtësinë e tij. Probleme të lehta mund të paraqiten prej përmbajtjes relativisht të lartë të karbonateve dhe bikarbonateve në dëmtimin e strukturës së tokës.

Ujrat nentokesore

Gjendja e mire ekologjike do te perkufizohet ne baze te parametrave biologjike. Parametrat kimike, fizike dhe hidro-morfologjike konsiderohen vetem si mbeshtetes per zhvillimin dhe ruajtjen e gjendjes se mire biologjike. Megjithate, kalibrimi i vlerave te parametrave biologjike me vlerat limite per gjendje te mire biologjike dhe te tjera klasifikime nuk jane kryer ne Shqiperi dhe ne vendet anetare te BE akoma është ne vazhdim. Ne kete situatë është e nevojshme te zbatohet parametrat kimike dhe disa te tjerë fizike për te përcaktuar vlerat limite te kufijve, bazuar ne vlerësimin e eksperteve.

- *Cilesia e ajrit ne zonen e studjuar*

ZHURMAT

Gjate zbatimit te projektit per ndertimin e pritave do kete angazhim te makinerive per punime germimi, transporti etj. Per te zbutur efektin e trafikut te ngarkuar dhe te zhurmave qe e shoqerojne ate, me qellim uljen e shqetesimeve per popullaten qe jeton perreth zones se ndertimit, si rruge te perkohshme do te perdoret rruga hyrese e lekbibajt dhe qe vazhdon deri ne pjesen e siperme afer aksit te ri te prites.

Zhurmat do të monitorohen sipas ditës e natës, për 8-orëshin gjatë ndërtimeve. Gjithashtu do të shihen se cilat pjesë përcaktojnë zhurmën, e cila qarkullohet vazhdimisht. Do të vërehen

kriteret dhe normat që duhet të përcaktojnë zhurmat. Menaxheri i vendit të ndërtimit duhet të mbajë dokumentacion për çdo zhurmë gjatë procesit të ndërtimit.

- *Administrimi i mbetjeve.*

Materiali i germuar do të përdoret për ndërtimin e rrugës së re hyrëse për në vendin e ndërtimit të pritave.

- *Problemet e tjera : si erozioni i tokës*

Ne ato zona ku ka probleme të erozionit do merren masa:

-Masat agro-teknike janë masat që janë të përshtatshme për të ndaluar ose zvogëluar erozionin dhe kështu ndalojnë ose zvogëlojnë humbjen e shtresës së pëlleshme të dheut nga toka bujqësore.

-Drunjtë në brezin mbrojtës janë një varg drunjesh ose shkurrësh të cilat janë mbjell për të ndaluar ose zvogëluar ndikimin e erozionit nga era në rrafshina ose erozionit nga uji në shpate ose në rrafshina që vërshohen.

-Nën mbjellja është mbjellja e barit ose llojeve tjera të bimëve, të cilat mbulojnë dheun e zhveshur rreth të mbjellave (kulturave) të cilat nuk e mbulojnë tokën ose lënë hapësira të mëdha të zhveshura të dheut. Qëllimi i nën mbjelljes është të ndalohet humbja e shtresës së pëlleshme të dheut prej ndikimit të erozionit nga era dhe uji.

-Bashkë mbjellja është mbjellja e barit ose llojeve tjera të bimëve mes rreshtave të kulturave bujqësore ku të mbjellat nuk e mbulojnë dheun ndërmjet rendeve. Qëllimi i bashkë mbjelljes është që të ndalohet humbja e shtresës së pëlleshme të dheut nga ndikimi i erozionit të shkaktuar nga era dhe uji.

- *Presionet kryesore të mjedisit në zonen e projektit , si ndotje të mjedisit, prerje pyjesh*

a. Ndikime në vlerat e pejsazhit etj.

Ndikime në pejsazhet, vlerat rekreative, sociale dhe ndërkufitare

| Vlera mjedisore/ Pejsazhesh | Vlera ekonomike (kullosore) | Aftësi rikrijuese dhe turistike | Vlera social edukative | Vlera ndërkufitare |
|--------------------------------|--------------------------------|------------------------------------|---------------------------|-----------------------|
| *** | **** | *** | *** | *** |

* nuk ka ** të ulta *** mesatare **** të larte

b. Ndikime në florë dhe vegjetation

| Periudha e ndertimit te pritave | Ndikime negative nga gëryerja | Ndikime negative të shkaktuara nga kimikate dhe hidrokarbure | Ndikime positive mbi florën dhe vegjetacionin |
|-------------------------------------|----------------------------------|---|---|
| Faza fillestare | * | * | * |
| Marja e lëndëve të para | * | * | * |
| Ndikime pas 5 vjetësh | * | * | * |
| Ndikime pas masave rehabilituese | * | * | * |

* nuk ka ** të ulta *** mesatare **** të larta

C .Ndikime në grupet kryesore faunistike

| Periudha e shfrytezimit te pritave | Ndikime mbi gjitarët | Ndikime mbi shpendët | Ndikime mbi faunën peshkore | Ndikime mbi zvaranikët |
|--|-------------------------|-------------------------|-----------------------------------|---------------------------|
| Faza fillestare | * | * | ** | * |

| | | | | |
|----------------------------------|------------------|---|----|---|
| Marja e lëndëve të para | * | * | ** | * |
| | *(mbi brejtësit) | | | |
| Ndikime pas 5 vjetësh | * | * | * | * |
| Ndikime pas masave rehabilituese | * | * | * | * |

* nuk ka ** të ulta *** mesatare **** të larta

11) **Pershkrimi i karakteristikave sociale te zones ku do te zhvillohet projekti**

Njesia e qeverisjes vendore qe administron zonen ku zhvillohet aktiviteti.

Pellgu i përroit të Lekbibajt ka një sipërfaqe prej 146 km² dhe shtrihet në pjesën lindore të Alpeve të Shqipërisë. Pellgu ujëmbledhës kufizohet nga m. Kakisë ne perëndim (2358.7 m) dhe m. Shtresës (2190,0 m), m. Boshit ne veri (2414.5 m) dhe m. Hekurave (2559.5 m), në lindje m, Dhive (2334.0 m) dhe m. Makinës (1780.0 m), në jug kufizohet me Liqenin e Komanit. Përroi i Lekbibajt përpara ndërtimit të HEC të Komanit dhe mbushjes së liqenit shkarkonte në lumin Drin rreth kuotes 135 m mbi nivelin e detit. Tashmë ai shkarkon në liqenin e Komanit në kuotat respektive të derivueshme të tij sipas planit të shfrytëzimit, por që në pjesën më të madhe të kohes së shfrytëzimit të deritanishem ka qenë ndërmjet kuotave 172-174 m mbi nivelin e detit. Në raste të veçanta kuota e liqenit të Komanit ka zbritur deri rreth kuotës 159,65 (25 Janar 1986) apo mesatarja mujore e muajve të verës të viteve 1992-93, rreth kuotës 162. Qëndrat e banuara brenda pellgut ujëmbledhës të Lekbibajt janë

fshatrat; Brisë, Salcë, Palç, Peraj, Gjonpepaj, Lekbibaj, Tetaj, Shëngjergj, Curraj i Poshtëm, Betoshë, Qerreç Mulaj, Curraj i Sipërm. Në rrjedhjen e sipërme nuk ka qendra të banuara. Pellgu ujëmbledhës nga pikëpamja administrative i përket Qarkut të Kukësit, Rrethit të Tropojës dhe Njësisë Administrative Lekbibaj.

Zona Gjeografike: Tropoja kufizohet në veri me Republikën e Kosovës dhe të Malit të Zi, në perëndim me Bashkinë Shkodër, në jug me bashkitë Vau i Dejës dhe Fushë-Arrëz dhe në jug-lindje me Bashkinë Has. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Bajram Currit.

- *Popullsia dhe aktivitetet kryesore ekonomike te zones.*

Aktivitetet Ekonomike, Aktivitetet Bujqësore dhe Blektorale.

Aktiviteti kryesor ekonomik për popllsinë vendore është bujqësia. Toka është e shpërndarë duke u mbështetur në Ligjin No.7501, nga ku fermerët përfituan sipërfaqe tokë bujqësore per fryme, e mjaftueshme kjo për të plotësuar nevojat e familjeve, por e pamjaftueshme në aspektin e një bujqësie intensive.

Një seri problemesh të tjera si mos mbajtja në gjendje pune e sitemit të ujitjes dhe mungesa e mekanizimit të bujqësisë, kanë ndikur drejtpërdrejtë në një rënie të përgjithshme të bujqësisë në keto zona. Si rezultat i kësaj, toka bujqësore në mjaft raste paraqitet e abandonuar, duke u përdorur kryesisht si kullote.

Të ardhurat, Standartet e jetesës dhe Punësimi.

Burimi kryesor i të ardhurave për popllsinë vendore në komunat e ndryshme, sigurohet nga punësimet në sektorin e bujqësisë dhe të ardhurat nga emigracioni. Popullsia rurale në qark, ndeshet me një seri problemesh, të tilla si mungesa e sistemeve të ujrave të zeza, mungesa e një infrastrukture të përshtatshme, mungesa e ujit të pijshëm dhe energjisë elektrike. Disa prej këtyre problemeve, u bënë më kritike madje në periudhën e tranzicionit në kuptimin e standarteve të jetesës në zonat e thella ose në kuptimin e thellimit të varfërisë më gjërë.

Transformimi i kooperativave bujqësore dhe mbyllja e mjaft ndërmarjeve pronë shtetërore në vitet e para të tranzicionit, si pasojë e ristrukturimit dhe privatizimit, solli si pasojë papunësinë.

Pamjaftueshmëria e tokës bujqësore dhe zhvillimi i sektorëve jo bujqësorë u shoqërua me hapjen e disa vendeve të punës, kryesisht në sektorin e ndërtimit. Në këtë situatë, në vecanti të rinjtë janë duke kërkuar një jetesë më të mirë në qytete në sektorët jo bujqësorë. Por, mundësitë janë të kufizuara edhe si pasojë e mungesës së kualifikimit të nevojshëm.

Emigracioni dhe të ardhurat.

Mekanizmi kryesor që buron nga kushtet e vështira të jetës është emigrimi dhe migrimi. Lëvizje të brendëshme migrimi ndeshen në më të shumtën gjatë zhvendosjes nga zonat malore të rrethit të Tropojës pasi sipërfaqja e tokës për banorë dhe cilësia e saj është shumë më e ulët në krahasim me atë të zonës së ulët. Përveç kësaj, zonat malore kanë një zhvillim të dobët të infrastrukturës dhe shërbimeve publike. Migrimet nga zonat rurale kanë krijuar probleme për pushtetin vendor. Këtu, në zonat malore, takohen sipërfaqe të tëra të cilat janë plotësisht të abandonuara.

Sidoqoftë, zona rurale e rrethit të Tropojës, karakterizohet nga një nivel i lartë i emigrimeve, për një periudhë kohe të shkurtër ose të gjatë, në vendet përreth. Shkaku kryesor për emigracionin është punësimi dhe sigurimi i të ardhurave për familjet e tyre. Të ardhurat përdoren kryesisht për plotësimin e nevojë ditore të jetesës në familje dhe sasi të tjera investohen në bujqësi ose sektorë të tjerë.

Aktivitetet turistike.

Në përgjithësi zona e marrë në studim dallohet për një zhvillim megjithëse ofron atraksione në aspektin e turizmit.

Duke u bazuar në burimet natyrore dhe qendrat e banuara, nxitja e formave alternative të turizmit duket si një perspektivë interesante për zhvillimin ekonomik të rajonit, ndërkohë që lipset respektimi i tërësisë së tij mjedisore, duke përfshirë edhe vlerat kulturore e historike.

Pamvarësisht përparimeve, turizmi paraqitet larg të qënurit zhvillim i kënaqshëm. Infrastruktura në aspektet e telekomunikacionit, furnizimit me ujë etj, është mjaft e varfër, ndërkohë që cilësia e shërbimeve ekzistuese turistike, (ngjitje ne mal, rreshqitje ski, gjueti etj), është e ulët.

Sidoqoftë, turizmi është duke marrë një theks të vecantë në kushtet e politikave të reja në vend, të përfshira edhe në Strategjinë për zhvillimin e vendit, si me i organizuari shfaqet turizmi familjar ku njerezit kthehen per pushime ne terren malor.

